

Janar 2020

Raport nga  
Grupi për Studime  
Juridike dhe Politike

# Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë

**ROLPIK**

[rolpik.org](http://rolpik.org)

**BOTIMI I PESTË**

**DREJTËSIA SOT**

[rolpik.org/justicetoday](http://rolpik.org/justicetoday)



British Embassy  
Pristina



Group for Legal  
and Political  
Studies



## **Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë Botimi i Pestë**

Janar 2020

©Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë, Janar, 2020

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërishtë ato të donatorëve të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, stafit, bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo nga çfarëdo mjeti pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesat e tilla.

### **Grupi për Studime Juridike dhe Politike**

Rr. "Rexhep Luci" 16/1

Prishtinë 10 000, Kosovë

[www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)

[office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)

+381 38 234 456

*Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk i reflekton qëndrimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe.*



## HYRJE

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (RoLPIK) është mekanizëm monitorimi, i hartuar për të vlerësuar punën e institucioneve më përqëndrim të veçantë në sistemin e drejtësisë në Kosovë. RoLPIK, shërben si platformë me të dhënat e hapura, të qasshme për publikun e gjerë, ku çdo vit analizohet e pasqyrohet puna e institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kosovë përgjatë viteve. Ky indeks përmban indikatorë të cilët ofrojnë të dhëna mbi perceptimet dhe eksperiencat e qytetarëve të Kosovës për institucionet e sundimit të ligjit, si dhe të dhëna strukturore të cilat paraqesin arsyet që kushtëzojnë funksionimin efikas dhe të pavarur të këtyre institucioneve.

Botimi i parë i indeksit të performancës, analizoi perceptimin e qytetarëve për institucionet e drejtësisë, dhe u fokusua kryesisht në matjen e performancës së efikasitetit të gjykatave. Indeksi i dytë vlerësoi performancën e sistemit prokurorial ndër vitet 2013-2015, ndërsa si vazhdimësi analizoi të dhënat e perceptimit qytetar për institucionet përgjegjëse për sundimin e ligjit, të realizuar gjatë muajit qershor të 2016-ës. Botimi i tretë vazhdoi tutje me matjet e perceptimit qytetar të realizuara gjatë muajit qershor të 2017-ës, si dhe performancën e sistemit të drejtësisë gjatë hetimit, gjykimit dhe zgjidhjes së rasteve për vitet 2013-2016. Ndërsa, analiza e të dhënave të perceptimit qytetar pas anketës së katërt të realizuar gjatë muajit qershor 2018, dhe matja e performancës së sistemit të drejtësisë në raport me hetimin, gjykimin dhe zgjidhjen e rasteve gjatë viteve 2013-2017, u bë gjatë botimit të katërt.

Botimi i pestë, ka për qëllim analizimin e të dhënave të perceptimit qytetar nga anketa e realizuar gjatë muajit shtator të vitit 2019, si dhe të mas performancën e sistemit të drejtësisë përgjatë vitit 2018, duke i krahasuar këto të dhëna me vitet paraprake.

Përceptimi qytetar paraqet përshtypjen e qytetarëve të një vendi për institucione të caktuara, në rastin konkret për institucionet të cilat janë ndërtuar për zbatimin e normave ligjore, prandaj ky indikator vlerësohet si shumë i rëndësishëm në vlerësimin e punës së autoriteteve shtetërore. Në këtë aspekt, duhet përmendur faktin që sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdimisht është karakterizuar me nisma e reforma të ndryshme të cilat kryesisht kanë rezultuar me ndryshime legjislative, me krijimin e mekanizmave të rinj ose shuarjen e tyre si dhe riaranzhim kompetencash brenda institucioneve të ndryshme. Të njëjtat janë cilësuar të jenë kryesisht ndryshime të cilat nuk kanë arritur të trajtojnë problemet në thelbin e tyre si mangësinë serioze që sistemi i drejtësisë ka në sigurimin e drejtësisë, pavarësisë dhe paanshmërisë nga akterët politikë dhe mungesën e profesionalizmit që mbizotëron në këto institucione. Pjesë e këtij cikli të reformave ishin dhe dy nisma të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat u zhvilluan përgjatë viteve 2018 – 2019, me qëllim kryesor të rikthimit të besimit të qytetarëve në drejtësi. Bëhet fjalë për agjenda “Drejtësia 2020” dhe “Rishikimin Funksional të Sektorit të Drejtësisë” të cilat ishin reforma paralele të lansuara nga Ministria e Drejtësisë por për shkak të rënies së Qeverisë, të njëjtat nuk janë përfunduar ende. Për më tepër, sistemi i drejtësisë kapërceu reformën e janarit të vitit 2013 për të formuar sistem të ri të gjykatave dhe prokurorive në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ligji për Gjykatat përcakton këtë sistem, të përbërë nga Gjykata Supreme me Dhomën e Posaçme të saj, si instanca më të larta gjyqësore dhe me juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me Gjykatën e Apelit si gjykatë të shkallës së dytë, me juridiksion në të gjithë territorin, si dhe Gjykatat Themelore, si gjykata të shkallës së parë të shpërndara në shtatë rajone, të ndara në divizione dhe departamente. Sistemi i ri prokurorial, Prokurorinë e Shtetit e organizon nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit si instanca më e lartë dhe me juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, nga Prokuroria e Apelit si shkallë e dytë, gjithashtu me kompetencë

mbi të gjithë territorin, Prokuroria Speciale si organ prokurorial të specializuar, me juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës si dhe Prokuroritë Themelore në shtatë rajonet e Kosovës, të ndara në departamente. Prandaj, marrë parasysh numrin e lartë të reformave të zhvilluara në këtë sektor, ky raport përmes këtij indeksi shpjegon përvojën e individit karshi këtyre institucioneve si dhe vlerëson punën e tyre përmes zgjidhjes së rasteve, duke synuar që në të ardhmen këto të dhëna të përdoren për funksionim të plotë të sistemit të drejtësisë me shpresë që reformat e ardhshme që aplikohen në këtë sektor të fillojnë pasi të mirren parasysh të gjeturat e këtij lloji të studimeve dhe jo reforma blanko.

## METODOLOGJIA

Ky raport është bazuar në të dhënat parësore si perceptimi qytetar dhe ato dytësore si raportet zyrtare nga organet përgjegjëse dhe menaxhuese të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Të dhënat parësore përfshijnë anketimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës gjatë muajit shtator 2019, të realizuara në bashkëpunim me UBO Consulting. Mostra e përzgjedhur për këtë anketim përbëhet nga 1071 të anketuar të moshës mbi 18 vjeç në të gjithë territorin e Kosovës me përkatësi shqiptare (963), serbe (54) dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera (54). Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë duke përdorur peshat e popullsisë dhe për të pasqyruar mostrën në pjesë urbane dhe rurale, nga të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Shtresimi i tretë është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim. Metoda e cila është përdorur për këtë anketim bazohet në përzgjedhjen rastësore të familjeve. Anketa është zhvilluar ballë për ballë me familjarin i/e cili/a ka ditëlindjen e parë më të afërt dhe është mbi moshën 18 vjeç. Para se të administrohej pyetësi në terren, fillimisht është bërë testimi i

pyetësorit për të identifikuar problemet logjike dhe përmbajtësore, si dhe është zhvilluar trajnimi i anketuesve. Në bazë të të dhënave të përfituara nga anketimi janë hartuar indikatorët e perceptimit të cilët vlerësojnë perceptimin e qytetarëve të Kosovës mbi punën e institucioneve të sundimit të ligjit: gjykatave, prokurorisë, policisë si dhe EULEX-it. Të gjitha pyetjet e anketës janë grupuar në nëntë indikatorë për të vlerësuar punën e institucioneve të sundimit të ligjit, nga këndvështrime të ndryshme.

Të dhënat dytësore për të vlerësuar efikasitetin e punës në gjykata dhe prokurori, janë mbledhur dhe analizuar nga raportet zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), dhe Ligjit për Buxhetin e Kosovës. Më konkretisht, janë analizuar të dhënat që lidhen me numrin e lëndëve të pranuar brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori; me numrin e lëndëve të trashëguara nga viti paraardhës; me numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; me popullësinë e Kosovës, si dhe buxhetin e ndarë për sistemin gjyqësor dhe prokurial gjatë viteve 2013, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018. Indikatorët strukturorë pasqyrojnë kapacitetet dhe resurset e prokurorisë, gjykatave për të realizuar detyrat e tyre, duke mundur në këtë mënyrë vlerësimin e efikasitetit të punës së tyre. Meqë nga janari i vitit 2013 ka hyrë në fuqi struktura e re e gjyqësorit, indikatorët bazohen në të dhënat e gjashtë viteve të fundit (2013, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018). Duhet theksuar se vlerësi dhe analizimi i numrit të lëndëve të zgjidhura apo të trashëguara brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori, është bërë pa vlerësuar vështirësinë e zgjidhjes së tyre, apo ndarjen në departamente të ndryshme të gjykatave dhe prokurorisë. Kjo pasi qëllimi kryesor në ndërtimin e indikatorëve strukturorë është që të vlerësojë efikasitetin total të punës së gjykatave dhe prokurorisë dhe të vlerësojë performancën individuale sasiore të prokurorëve dhe gjyqtarëve.







## **PËRCEPTIMI QYTETAR MBI INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË**



Një prej qëllimeve të rëndësishme të këtij raporti është vlerësimi i përceptimit të qytetarëve mbi punën e institucioneve të sistemit të drejtësisë ndër vite, duke qenë këto gjykatat, prokuroria, policia si dhe vetë Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosvoë (EULEX). Përshtypja e qytetarëve e analizuar në këtë botim, bazohet në rezultatet e dalta nga seria e pestë e anketave të realizuara gjatë vitit 2019. Këto përgjigje synojnë të vlerësojnë përshtypjen e qytetarëve ndaj institucioneve. Përceptimi i tyre në këtë botim është krahasuar për të gjetur ndryshimet ndër vite të këtij përceptimi, për të pasqyruar rënjet dhe uljet e imazhit të organeve zbatuese dhe bartëse të sundimit të ligjit në Kosovë. Fokus i këtij botimi, si në edicionin e kaluar, është përceptimi publik i punës së institucioneve ndaj luftës kundër korrupsionit, duke vlerësuar sipas indikatorëve të veçantë performancën e punës së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

## NDIKIMI POLITIK

Qytetarët e Kosovës mendojnë se institucionet e drejtësisë nuk i trajtojnë ata në mënyrë të barabartë. Rezultatet e anketave tregojnë se rreth 65.2% e qytetarëve besojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen për shkelje të ligjit, ndërsa vetëm 17.5% prej të anketuarve mendojnë se pozicioni apo influenca politike nuk krijon pabarazi në zbatimin e ligjit. Krahasuar me vitin e kaluar trendi i qytetarëve të cilët besojnë se sistemi i sistemi drejtësisë ndikohet nga pozicioni politik, është trend në ulje për 5.5%. Ky ndryshim pozitiv, duhet gjykuar pa u ndarë nga tërësia, sepse të dhënat tregojnë se më shumë se gjysma e popullsisë mendon se influenca politike të bën të jesh i paprekshëm nga ligji.

Nga pyetësi, vërehet se qytetarët e përceptojnë Policinë e Kosovës ndër institucionet më pak të ndikuar nga politika, ndërsa gjykatat dhe prokurorinë i mendojnë si institucionet më të ndikuara nga influenca politike.


A mendoni se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji?



Të anketuarit në përgjigjen ndaj pyetjes se cilat institucione influencohen më shumë nga ndikimi politik, rreth 34.4% besojnë se janë gjykatat, 29.5% prokuroria, e 18.4% policia. Të ndikuar nga politika qytetarët e konsiderojnë edhe Misionin Ndërkombëtar të EULEX-it, rreth 10.4%. Në përgjithësi të dhënat të krahasuara me vitin e kaluar tregojnë se qytetarët kanë filluar të kenë më shumë besim në institucione, ku nga 72.4% e qytetarëve që besonin se gjykatat ishin më të influencuara nga politika, tani kemi vetëm 34.4% prej tyre që ndajnë këtë mendim; tek prokuroria nga 68.3% tashmë përqindja është zvogëluar në 29.5%; e njëjta vlen dhe tek policia ku nga 47.8% kemi ulje pozitive në 18.4%. Por duhet thënë se pavarësisht këtij përmirësimi të imazhit të institucioneve, shtetasit e Kosovës vazhdojnë të besojnë se në masë të madhe politika është dora e padukshme e cila përcakton nëse një qytetar është mbi apo nën ligjin.

Cilat nga institucione në vazhdim influencohen më shumë nga ndikimi politik?

I anketuari mund të përgjigjet në më shumë se një përgjigje




## MITMARRJA


Institucionet e drejtësisë vazhdojnë të jenë të prekura nga dukuria e mitmarrjes, kështu besojnë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nga rezultatet e anketave të vitit 2019, të dhënat tregojnë se 48.6% e të anketuarve mendojnë se punëtorët e zyrtarët e institucioneve të sundimit të ligjit pranojnë dhe kërkojnë mito. Në krahasim me vitin paraprak përqindja është ulur për 6.5%, por perceptimi negativ mbetet mendim i shumicës së përgjithshme të të anketuarve. Është shqetësuese që vetëm 22.5% e të pyeturve mendojnë se zyrtarët që do të duhej të zbatonin ligjin nuk do të praninin apo kërkonin mito. Vlen të përmendet se besimi i qytetarëve tek institucionet ka filluar të ketë rritje por kjo rritje në krahasim me mendimin e përgjithshme negative mbetet e papërfillshme. Të anketuarit besojnë se institucionet më të prekura nga kjo dukuri janë gjykatat dhe prokuroria me rreth 64.2%. Kurse praktika e mitmarrjes sipas qytetarëve është më pak prezente tek policia e Kosovës, me 19.9% dhe më e ulët tek EULEX-i me 11.2%. Bindja se ekziston mitmarrje te instiucionet kyçe te cilat do të duhej të implementonin dhe të zbatonin ligjin, është pengesë serioze për ndërtimin e një shteti të së drejtës në Kosovë.

### Zyrtarët/punëtorët e cilit institucion në vazhdim kërkojnë/pranojnë mito?

I anketuari mund të përgjigjet në më shumë se një përgjigje





Sipas mendimit tuaj, zyrtarët/punëtorët e institucioneve të drejtësisë a kërkojnë/pranojnë mito?



## EFEKTIVITETI NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Si institucionin më efektiv në luftimin e korrupsionit, qytetarët e radhisin policinë e Kosovës, në 29.6% të rasteve. Është vërejtur një ndryshim i gjendjes nga viti paraprak ku besueshmëria ndaj prokurorisë është ulur në krahasim me gjykatën. Përderisa më parë mendohej që më pak efektive nga të gjitha institucionet në luftimin e korrupsionit ishin gjykatat, tani në këtë pozicion qytetarët e vendosin prokurorinë me përqindjen më të ulët prej 4.5%. Për nga efektiviteti në luftën kundër korrupsionit të anketuarit i radhisin institucionet si në vijim: Prokuroria 4.5%, Gjykatat 5.5%, EULEX-i 6.7%, Agjencia Kundër Korrupsionit 18.8%, Mediat 22.7%, Policia e Kosovës 29.6%. Pra edhe këtë vit si në vitet e mëhershme, qytetarët nuk u besojnë prokurorisë dhe gjykatave në luftimin e korrupsionit, madje as EULEX-it, të cilët një herë e një kohë konsideroheshin si prijës të kësaj lufte. Megjithatë, opinioni i qytetarëve është përmirësuar për Policinë e Kosovës, duke tejkaluar përshtypjet e mëparshme ndaj rolit pozitiv të medias dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit, sa i përket efikasitetit në luftimin e kësaj dukurie negative.

Sipas mendimit tuaj, cili nga institucionet në vazhdim është më efektiv në luftën kundër korrupsionit




## RAPORTIMI I KORRUPSIONIT

Gatishmëria e qytetarëve të Kosovës për të raportuar korrupsionin dhe veprat penale, ekziston në masë të madhe përkundër faktit që ata janë të pakënaqur me punën e institucioneve në luftimin e këtyre dukurive në shoqëri. Të pyetur nëse do të ishin të gatshëm të raportonin një rast korrupsioni apo krimi, 69.2% kanë thënë se janë të gatshëm ta raportojnë, ndërsa 21.8% kanë thënë që nuk janë të gatshëm ta bëjnë atë. Nga vitet e kaluara trendi i gatishmërisë për raportimin e korrupsionit tek institucionet relevante është negativ. Përderisa më parë, 15.6% e qytetarëve thonin se nuk ndjejnë gatishmërinë për raportim, tani masa e qytetarëve që i bashkohen këtij mendimi është 21.8%. Numri i qytetarëve të pavendosurë a do ta raportonin një rast të korrupsionit, ka filluar të jetë më i ulët, nga 17.5% sa ishte vitin e kaluar në 9.2% sa është këtë vit. Ulja e numrit të qytetarëve të pavendosur si përqindje duket se është bërë me zhvendosjen e rangut të atyre të cilët nuk do të raportonin këto dukuri negative. Numri i atyre që nuk do kishin gatishmëri për raportime është rritur për 6.2%, në krahasim me rritjen prej 2.3% të atyre që janë përgjigjur se do të raportonin për të ndihmuar institucionet në luftimin e korrupsionit. Kjo tendencë e uljes së aktivizimit qytetar për të kontribuar në adresimin e dukurive negative, është tregues i përvojave personale të kaluara qytetare me institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë. Ulja e gatishmërisë është një mesazh i qartë që tregon se qytetarët janë të pakënaqur më mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së rasteve nga ana e organeve të drejtësisë, në të kaluarën.


Të pyetur se në cilin institucion do të raportonin korrupsionin, 78.7% e qytetarëve të intervistuar janë përgjigjur se do të raportonin në polici. Në prokurori dhe në gjykata përqindja e të intervistuarve që do të raportonin korrupsionin mbetet e ulët krahasuar me ata të cilët do përzgjidhnin policinë. Rreth 0.8% e të anketuarve do

të lajmëronin gjykatat, ndërsa 1.4% në prokurorinë. Ndryshe nga viti i kaluar për 1.4% është ulur numri i njerëzve të cilët do të raportonin padrejtësitë, ose shkeljet në prokurori. Ky rezultat i anketave tregon se policia vazhdon të jetë adresa më e besueshme e qytetarëve për të raportuar veprat penale.

Në qoftë se do të vërenit ndonjë rast të korrupsionit apo krimi (vjedhje, dhune, etj), a do të ishit të gatshëm ta raportonit?



Në cilin institucion do ta raportonit?



## KËNAQSHMËRIA


Indikator i kënaqshmërisë tregon sesa institucionet e drejtësisë veprojnë në përputhje me pritshmëritë e qytetarëve dhe përgjegjësitë e tyre. Të dhënat për vitin 2019, ngjashëm si në vitet e kaluara tregojnë se qytetarët janë më të kënaqur me Policinë e Kosovës, ndërsa shumë pak të kënaqur me EULEX-in. Pyetja e cila u është parashtruar anketuesve është: “sa jeni të kënaqur me punën apo performancën e këtyre institucioneve”. Ndërsa përgjigjia mund të derivonte nga vlera 1 që korrespondon me

aspak të kënaqur deri në vlerën 5 plotësisht të kënaqur. Sipas përgjigjeve të qytetarëve radhitja e institucioneve sipas mesatares qëndron kështu: Policia e Kosovës 3.77, Gjykatat e Kosovës 2.99, Prokuroria e Kosovës 2.85 dhe në fund EULEX-i me 2.37. Gjithsesi përmirësime të vogla janë vërejtur në kënaqshmërinë e qytetarëve ndaj çdo njërit nga institucionet, por me përçindje më të lartë ato duken tek gjyqësori me një rritje prej 0.26, ndërsa ndryshimi më i ulët është vënë re tek misioni i EULEX, në vlerë prej 0.04.

Sa jeni të kënaqur me punën/performancën e këtyre institucioneve?



1=Aspak i kënaqur dhe 5=Plotësisht i kënaqur



## PAVARËSIA NË VENDIMARRJE



Pavarësia dhe paanshmëria janë parime e kushte që një shtet të ketë sistem funksional të së drejtës. Sa i përket pavarësisë së institucioneve të cilat mbrojnë ligjshmërinë, 37.7% e qytetarëve edhe këtë vit e radhisin policinë si institucion që mund të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur. Ndërsa vetëm 11.7% e të anketuarve mendojnë se gjykatat mund të jenë të pavarura në ushtrimin e detyrës së tyre, njashtu edhe për prokurorinë, përqindja është vetëm 12.5%. Përderisa përqindja e qytetarëve që besojnë se policia mund të kryej punë të paanshme është rritur për 2.4%, kjo nuk vlen dhe për institucionet e tjera. Përceptimi nga viti 2018 tani është më i ultë për gjykatat, prokurorinë madje edhe EULEX-in. Vlen të përmendet që qytetarët pavarësisht se janë përgjigjur që janë të kënaqur me punën e misionit të EULEX, përqindja e atyre që mendojnë se ky mision mund të bëj punë të pavarur ka rënë në mënyrë drastike.

Përceptimi i qytetarëve, tregon se parimi i pavarësisë në vendimarrje duket të jetë shumë pak i zbatueshëm nga organet e sundimit të ligjit në vend. Rënja e besueshmërisë në pavarësinë e institucioneve nga viti 2018, në 2019-ën tregon se qytetarët mendojnë që pavarësia në organet gjyqësore dhe prokuroriale është pothuajse e pamundur.


Përderisa qytetarët e mendojnë gjykatën si institucionin më pak të pavarur në ushtrimin e detyrave ligjore, rreth 37.4% mendojnë se gjyqtarët vendimarrjen e bazojnë nën ndikimin e presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë apo personat me influencë politike. Numri i qytetarëve që e ndajnë këtë mendim nga viti i kaluar është rritur për 6%. Në vendimet e bazuara në kornizën ligjore besojnë më pak se 30% e tyre, ndërsa 31.7% e konsiderojnë se gjyqtarët ndikohen nga presioni, korrupsioni dhe interesi privat. Përdersia 69.1% e shtetasve të Kosovës ndajnë mendimin se gjyqësori ndikohet nga interesat private në vendimarrje., ky indikator pasqyron përvojat negative të tyre me këtë institucion.

Sipas mendimit tuaj, në praktikë, cilat nga institucionet e Kosovës në vazhdim janë në gjendje të kryejnë detyrat/përgjegjësitë e tyre në mënyrë të pavarur?

I anketuari mund të përgjigjet në më shumë se një përgjigje




Sipas mendimit tuaj, gjatë marrjes së vendimit shumica e gjyqtarëve në Kosovë bazohen:




## PËRMIRËSIMI I GJYQËSORIT

Përkundër agjendës “Drejtësia 2020” dhe procesit të Rishikimit Funkcional, që të dyja të nisura nga Ministria e Drejtësisë, me qëllim kryesor sigurimin e mbarëvajtjes dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në drejtësi, më shumë se gjysma e qytetarëve mohojnë të kenë vërejtur përmirësim në sistemin e drejtësisë. Epavarësisht funksionalizmit të Departamentit Special, të paraparë me Ligjin për Gjykatat qysh nga viti 2018, duket se pak ndryshime ka pasur në mendimet e qytetarëve mbi përmirësimin e gjyqësorit.

Sipas mendimit tuaj, a është përmirësuar sistemi i drejtësisë gjatë viteve të fundit?



Cili nga këto dimensione të sistemit të drejtësisë është përmirësuar më së shumti?



Më pak se 30% besojnë se kanë vërejtur efekte pozitive, ndërsa 19.6% kanë qenë pa përgjigje.

Në mesin e atyre 30% të qytetarëve të cilët besojnë se sistemi gjyqësor është përmirësuar, 27.6% mendojnë se tashmë ka më pak ndikim të politikanëve mbi gjyqtarët, 24% besojnë se është përmirësuar hetimi ndaj rasteve të korrupsionit, 23.4% besojnë se rastet zgjidhen më shpejtë dhe po aq mendojnë që gjykatat tani janë më transparente dhe llogaridhënëse. Dimensi i sistemit të drejtësisë që duket se është përmirësuar më pak, është mbi të gjitha shpejtësia e mbylljes dhe zgjidhjes së rasteve pasi që përqindja e qytetarëve që besojnë se ka pasur përmirësime në këtë drejtim nga viti i kaluar ka qenë në rënie të lirë nga 42.4% në 23.4% për këtë vit.





## KUSHTET E PUNËS

Shumë pak qytetarë besojnë se merren masa disiplinore deri në largim nga puna ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve, për shkelje të rregullave apo procedurave. Ata të cilët ndajnë këtë mendim janë vetëm 17.8%, prej të cilëve 6.5% besojnë se shpesh ndërmerren masa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndërsa 11.3% thonë se gjithmonë merren masa ndaj tyre. Është e rëndësishme të theksohet se në krahasim me vitin e kaluar perceptimi ka ndërruar në aspektin pozitiv, ku tani për 12.4% më shumë besojnë se masa disiplinore u jepen edhe gjyqtarëve e prokurorëve. Megjithatë nuk duhet harruar se 43.2% e


shtetasve të Kosovës mendojnë se gjasat që të ndërmerren masa disiplinore ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve si shkelës të rregullave apo procedurave janë të vogla, prej tyre 14.2% mendojnë që asnjëherë nuk ndëshkohen as gjyqtarët e as prokurorët, kurse 30.8% mendojnë që kjo është një dukuri shumë e rrallë.

Përpos që shumica e qytetarëve e përceptojnë gjyqësorin dhe prokurorinë si të paprekshme nga sanksionet po që se shkelin rregulla, prap shumica e qytetarëve rreth 44.7% pajtohen se po këta gjyqtarë dhe prokurorë, nuk kanë mjetet e as burimet e nevojshme për t'u mbrojtur nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet apo frikësimet.


Sipas mendimit tuaj, a ka gjasë që të merren masa disiplinore deri në largim nga puna ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të cilët i shkelin rregullat apo procedurat?



Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim:



“Gjykatat/prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet”



## MANDATI I EULEX-it


Këtë vit për 3.9% më shumë, qytetarët ishin të bindur se mandati i EULEX-it nuk duhet të vazhdoi, duke bërë që 48.1% të të anketuarve të kenë këtë qëndrim. Ndërsa 23.8% nuk ishin të sigurtë se çfarë duhet të bëhej më tutje me misionin ndërkombëtar në Kosovë, duke lënë kështu vetëm 28.1% të anketuarve të mendimit se mandati duhet të zgjatet. Nga vitet e kaluara vërehet një ndryshim i perceptimit të qytetarëve, ku tashmë numri më i madh i tyre rreshtohen në grupin e atyre që mendojnë se mandati i EULEX-it nuk duhet vazhduar, duke ulur kështu numrin e qytetarëve të cilët ishin të pasigurtë se çfarë duhet bërë ndër vite me atë. Ky është një indikator që tregon se shumë qytetarë janë skeptik sa i përket nevojës së mëtejshme për një institucion të tillë në Kosovë.

Cili është mendimi juaj sa i përket mandatit të EULEX:



Nuk jam i sigurt  
**23.8%**

Duhet të vazhdojë  
**28.1%**



Duhet të përfundojë  
**48.1%**

# **VLERESIMI I PUNËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË**

## Vlerësimi i Punës së Sistemit të Drejtësisë

Vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë në botimin e parë të Indeksit u fokusua në vlerësimin e efikasitetit të punës së sistemit gjyqësor në zgjidhjen e rasteve, përmes analizimit të të dhënave për çdo gjykatë gjatë viteve 2013-2015. Ky botim u fokusua në nxjerrjen e të dhënave për këtë sistem pas aplikimit të reformës së atëhershme legjislative dhe strukturore të sistemit të drejtësisë. Botimi i dytë e kishte për synim efikasitetin e punës së sistemit prokurorial në Kosovë, si organ i paanshëm, i pavarur, për ndjekjen e veprave penale dhe shkeljeve të normave ligjore. Më pas, botimi i tretë u përqëndrua në analizën e punës së gjykatave dhe prokurorive përgjatë vitit 2016, sikurse botimi i katërt që pasqyronte performancën e këtyre dy institucioneve përgjatë vitit 2017. Botimi i pestë synon të vlerësoj performancën e sistemit të drejtësisë për vitin 2018, duke e krahasuar atë me punën përgjatë viteve paraprake.

Ngjashëm me botimin e katërt në mënyrë që vlerësimi i efikasitetit të jetë efektiv, janë ndjekur strukturat organizative në bazë të të cilave funksionojnë sistemi prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë. Vlerësimi i punës së sistemi prokurorial është bërë për: Zyrën e Kryeprokurorit, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale dhe Prokuroritë Themelore. Prandaj edhe të dhënat nga sistemi gjyqësor janë analizuar të ndara në bazë të punës së Gjykatës Supreme, Dhomës së Posaçme, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore.

Efikasiteti i punës së sistemit të ndjekjes penale dhe mbrojtjes së ligjshmërisë, janë vlerësuar nga të dhënat zyrtare të siguruar nga organet e Këshillit Prokurorial të

Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ligjit për Buxhetin e Kosovës, etj. Nga këto të dhëna zyrtare janë krijuar indikatorë strukturorë të cilët synojnë të vlerësojnë punën e sistemit të drejtësisë nga prespektiva të ndryshme. Indikatorët strukturorë tregojnë aspekte të performancës së sistemit prokurorial dhe gjyqësor, nga vlerësimi i kërkesës për drejtësi, numri i lëndëve të zgjidhura, efikasiteti i punës, ngarkesa e prokurorëve dhe gjyqtarëve, shkalla e mbipopullimit dhe koha për të cilën me punë të njëjtrajtshme sistemi do të arrinte të përmbyllte lëndët aktuale, e deri tek analizimi i shkallës së ndarjes së buxhetit për të vlerësuar priorizimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Analiza e punës së prokurorisë dhe gjykatave është e varur nga shumë faktor të jashtëm dhe të brendshëm, prandaj duhet pasur parasysh që ky vlerësim nuk mund të identifikoj të gjithë indikatorët relevant që përcaktojnë vëllimin e punëve të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Ky raport në kapitujt vijues synon të pasqyroj faktorët më parësor përmes të cilëve në aspektin sasior përcaktohet puna e sistemit prokurorial dhe gjyqësor, duke e krahasuar atë me efektivitetin e këtyre organeve përgjatë viteve 2013 - 2018. Përmes këtij vlerësimi raporti ka për qëllim të shtjellojë të dy anët e medaljes, nga prespektiva e qytetarit deri tek puna e cila zhvillohet në organet e drejtësisë, në mënyrë që këto mangësi dhe pengesa në të ardhmen të përdoren për t'u eliminuar, me një planifikim më adekuat për përsosjen e sistemit të sundimit të ligjit në Kosovë.

# **PERFORMANCA E PROKURORIVE**

## PERFORMANCA E PROKURORIVE

### Numri i lëndëve të reja/lëndëve të zgjidhura

Lëndët e reja të cilat prokuroria i pranon brenda një viti tregojnë potencialin për punën të çdo prokurorie. Ndërsa potenciali i lëndëve për t'u zgjidhur brenda një viti përmbushet vetëm për numërin e caktuar të rasteve të zgjidhura. Të dhënat si “numri i lëndëve” tregojnë për ngarkesën e prokurorive përkatëse, si dhe pritshmërinë e shoqërisë për punë karshi këtij institucioni. Në anën tjetër indikator i “lëndëve të zgjidhura” tregon për kapacitetin e këtij organi për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë. Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë mesataren e lëndëve të reja dhe të zgjidhura, të ndara për çdo organ të prokurorisë, që tregon numrin e rasteve për atë organ në raport me numrin e prokurorëve të angazhuar brenda një viti. Nga të dhënat e mbledhura, duket se Zyra e Kryeprokurorit gjatë vitit 2018, ka pasur numrin më të ulët ndër vite të lëndëve të reja për 1 prokurorë. Mesatarja e lëndëve të zgjidhura këtë vit ka qenë më e lartë se mesatarja e lëndëve të pranuar. Kjo mund të jetë një tregues që rritja e numrit të prokurorëve të angazhuar për dy nga viti 2017, ka rezultuar me rritjen e marzhit të punës nga ky organ. Prokuroria Speciale këtë vit ka pasur një mesatare më të madhe të lëndëve të zgjidhura në krahasim me mesataren e lëndëve të pranuar. Për herë të parë këtë vit Prokuroria e Apelit, nuk ka arritur të ndjek trendin e të përfunduarit të të gjitha lëndëve të pranuar brenda vitit, e kjo për shkak se numri i prokurorëve është ulur për dy nga viti i kaluar. Prokuroritë Themelore kanë arritur të shënojnë një mesatare më të lartë të lëndëve të zgjidhura, në krahasim me mesataren e lëndëve të hapura brenda vitit.

**Tabela I. Mesatarja e lëndëve të reja të pranuar kundrejt lëndëve të zgjidhura**

Viti	Zyra e Kryeprokurorit	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	138	141
2017	201	198
2016	228	231
2015	396	403
2014	153	146
2013	212	215

Viti	Prokuroria Speciale	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	14	141
2017	15	198
2016	12	231
2015	9	403
2014	12	146
2013	11	215

Viti	Prokuroria e Apelit	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	1148	1148
2017	724	724
2016	880	880
2015	645	645
2014	549	549
2013	584	584


Viti	Prokuroritë Themelore	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	323	411
2017	375	475
2016	229	257
2015	250	234
2014	255	182
2013	320	255

## Efikasiteti i prokurorive në zgjidhjen e lëndëve

Përmes vlerësimit të efikasitetit të punës së prokurorisë pasqyrohet gatishmëria e sistemit prokurorial të përgjigjet ndaj kërkesës për mbrojtje të sistemit të së drejtës brenda një viti. Efikasiteti edhe këtë vit është kalkuluar duke krahasuar raportin e lëndëve që pranojnë institucionet e prokurorisë, në krahasim me numrin e lëndëve të zgjidhura. Në tabelë shihen përqindjet e efikasitetit, ku vlera 100% tregon se prokuroria ka qenë plotësisht efikase në zgjidhjen e të gjitha lëndëve të cilat i ka pranuar gjatë atij viti. Kur kjo përqindje është me e vogël se 100% tregon se ai organ nuk ka arritur të përfundoj të gjitha lëndët e pranuar. Ndërsa kur përqindja është me e lartë se 100%, tregon se prokuroria ka arritur të përfundoj më

shumë lëndë sesa që ka pranuar, duke ulur numrin e lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake. Zyra e Kryeprokurorit në vitin 2018 ka shënuar një efikasitet më të lartë në krahasim me vitin 2017, me ç'rast ka arritur për 2% të ul numrin e lëndëve të trashëguara për vitin 2019. Prokuroria Speciale dhe Prokuroritë Themelore për vitin 2018 kanë treguar të njejtën tendencë, pra kanë rritur efikasitetin për të trajtuar lëndë të trashëguara nga e kaluara. Përderisa Prokuroria e Apelit pas pesë vitesh me të njëjtin ritëm pune, për herë të parë këtë vit ka treguar një efikasitet negativ, duke mos arritur të përfundoj lëndët të cilat i ka pranuar. Gjithmonë duhet pasur parasysh edhe uljen e numrit të prokurorëve të angazhuar në një organ, siç është rasti me Prokurorinë e Apelit në këtë rast, në krahasim me prokuroritë e tjera të cilat kanë shënuar një rritje në indikatorin e efikasitetit.

**Tabela II. Efikasiteti i prokurorive në zgjidhjen e lëndëve**



## Ngarkesa e Prokurorëve

Përmes përcaktimit të shkallës së ngarkesës së prokurorëve identifikohet numri mesatar i lëndëve që një prokuror pritët t'i zgjidh brenda një viti pune. Përlllogaritja e këtij indikator bëhet përmes shumës së lëndëve të pazgjidhura në fillim të vitit dhe lëndëve të reja të pranuar, në raport me numrin e prokurorëve të angazhuar gjatë po këtij viti. Këto lëndë nuk janë trajtuar në aspektin cilësor të vështirësisë, por vetëm në aspektin sasior të numrit të lëndëve të cilat i pranon një prokuror brenda vitit. Përdersia në vitet paraprake për të gjithë hallkën e sistemit prokurorial ishte ulur numri i lëndëve të pranuar, në vitin 2018 kjo nuk vlen për Prokurorinë Speciale, të Apelit dhe Prokuroritë Themelore, të cilat kishin një rrjedhë më të madhe të lëndëve. Rrjedhimisht kjo përkthehet edhe në ngarkesë më të madhe për prokurorët e angazhuar në shkallën e parë dhe të dytë të sistemit prokurorial.

Sipas mënyrës së organizimit të prokurorive, ngarkesa më e madhe me lëndë si mesatare për vitin 2018 ishte për Prokurorinë e Apelit, e përcjellur nga Prokuroritë Themelore dhe Prokuroria Speciale. Ndërsa, Zyra e Kryeprokurorit ka pasur një mesatare më të ulët të numrit të lëndëve, në pritje për t'u zgjidhur nga prokurorët gjatë 2018-ës.

**Tabela III. Ngarkesa e Prokurorëve**

Viti	Zyra e Kryeprokurorit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2018	142	116	1148	1047
2017	203	46	724	404
2016	234	72	880	506
2015	412	53	645	540
2014	155	50	549	463
2013	217	48	584	509



## Shkalla e mbipopullimit të prokurorive

Përmes të dhënave nga ky indikator parashikohet sesa kohë do të duhej për të përfunduar të gjitha lëndët e grumbulluara brenda një viti në një sektor, po qe se sasia e punës nga prokuroria do të ishte një konstante. Bazuar në performancën e prokurorisë nga vitet paraparke, përmes shkallës së mbipopullimit mund të vlerësojmë për afërsisht efikasitetin që do t'u duhej prokurorëve në të ardhmen, për të përfunduar të gjitha lëndët. Të dhënat në këtë tabelë tregojnë numrin e lëndëve të reja dhe të trashëguara në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura. Siç duket, Zyrës së Kryeprokurorit dhe Prokurorisë së Apelit do t'u duhej pak më shumë se 1 vit efikasitet pune për të përmbyllur të gjitha lëndët pa pranuar asnjë lëndë të re. Prokurorisë Speciale në anën tjetër do t'i duhej diku më shumë se 7 vite, për të përfunduar vetëm lëndët të cilat i ka në dispozicion aktualisht, ndërsa Prokurorive Themelore do t'u duhej më shumë se 2 vite gjithsej.

**Tabela IV. Shkalla e mbipopullimit**

Zyra e Kryeprokurorit				
2018				101
2017				104
2016				101
2015				102
2014				106
2013				101
<b>Prokuroria Speciale</b>				
2018				766
2017				395
2016				314
2015				462
2014				826
2013				479
<b>Prokuroria e Apelit</b>				
2018				101
2017				100
2016				100
2015				100
2014				100
2013				100
<b>Prokuroritë Themelore</b>				
2018				255
2017				157
2016				197
2015				231
2014				255
2013				199

## Buxheti

Përmes buxhetit mund të parashikohet për çdo vit sesa prioritet ka qenë sistemi i drejtësisë në vitin paraprak. Të dhënat për buxhetin e ndarë ndër vite për Këshillin Prokurorial të Kosovës, tregojnë një rritje të vazhduar qysh nga viti 2013, në proporcion me rritjen e buxhetit të shtetit të Kosovës. Në vitin 2018, u tejkalua vlera prej 9.5 milionë EUR sa ishte ndarë për KPK-në gjatë vitit 2017, duke arritur shumën prej 11 milionë EUR.

Në përqindje shpërndarja e buxhetit të Kosovës për sistemin prokurorial nuk arrin as 1% të buxhetit të shtetit, përkundër rritjes progresive të shumës së ndarë për organet e prokurorisë. Si në të kaluarën, rritja e të ardhurave, planifikimi dhe hartimi i linjave buxhetore të rritura për KPK-në nuk kanë ardhur si rezultat i ndonjë politike për prioritizimin e sistemit të drejtësisë, apo bazuar në ndonjë vlerësim të nevojave, por gjithmonë kanë ardhur si rezultat i rritjes së buxhetit vjetor të Kosovës.

Buxheti i paraparë për prokurorinë gjatë vitit 2018 është shpërndarë 65% për paga dhe mëditje, 19% për mallra dhe shërbime, 2% për shpenzime komunale dhe 14% për shpenzime kapitale. Kjo shpërndarje tregon se prioritet i autoriteteve menaxhuese të sistemit prokurorial janë pagat dhe mëditjet, duke lënë shume pak hapësirë për planifikim e ndarje të mjeteve monetare për ngritje kapacitetesh, profilizim të prokurorëve dhe stafit mbështetës.

**Tabela V. Buxheti i Sistemit Prokurorial**

	Buxheti i KPK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2018	<b>11,092,826€</b>	2,080,480,837€	<b>0.53</b>
2017	<b>9,483,682€</b>	2,001,020,484€	<b>0.47</b>
2016	<b>8,013,619€</b>	1,678,709,487€	<b>0.48</b>
2015	<b>7,158,086€</b>	1,682,486,849€	<b>0.43</b>
2014	<b>6,872,000€</b>	1,589,324,952€	<b>0.43</b>

**Tabela VI. Shpërndarja e Buxhetit në Sistemin Prokurorial të Kosovës në %**

### SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË SISTEMIN PROKURORIAL TË KOSOVËS NË %

	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Shpenzime Kapitale
2018	<b>65.25</b>	<b>18.67</b>	<b>1.80</b>	<b>14.28</b>
2017	<b>69.59</b>	<b>15.04</b>	<b>2.10</b>	<b>13.26</b>
2016	<b>79.91</b>	<b>16.73</b>	<b>2.49</b>	<b>0.87</b>

**VLERËSIMI  
I PUNËS SË  
GJYKATAVE**

## Performanca e Gjykatave Numri i lëndëve të reja/lëndëve të zgjidhura

Varësisht sesa lëndë të reja pranon çdo gjykatë në sistemin gjyqësor në Kosovë brenda një viti, nga kjo përcaktohet edhe puna që e pret institucionin në zbatimin dhe mbrojtien e ligjit. Ky numër i lëndëve të reja së bashku me numrin e lëndëve të trashëguara janë indikatorë i ngarkesës së gjykatave për punë gjatë një viti kalendarik. Kurse numri i lëndëve të zgjidhura është faktor që tregon kapacitetin e tyre për të zgjidhur lëndët të cilat i vihen në barrë këtyre institucioneve. Nga tabela portretizohet ngarkesa mesatare me lëndë të reja për secilën gjykatë, në përpjestim me numrin e gjyqtarëve të angazhuar në atë gjykatë. E njëjta vlen edhe për mesataren e lëndëve të zgjidhura brenda vitit. Të dhënat për 2018-ën tregojnë se Gjykata Supreme ka pasur një ngarkesë më të madhe me lëndë në krahasim me vitet e kaluara. Në këtë gjykatë numri i lëndëve të zgjidhura është më i ulët sesa i atyre të cilat presin zgjidhje, pavarësisht që numri i gjyqtarëve të angazhuar në këtë vit është për katër më i madh sesa vitin paraprak. Në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, numri i lëndëve si mesatare është më i ulët i shënuar ndonjëherë, ndërkohë që mesatarja e lëndëve të përfunduara është edhe më e ulët se lëndët që janë paraqitur në gjykatë. Vllugu i punëve për Gjykatën e Apelit ishte

më i ulët në krahasim me vitet 2017, e 2016, ndërsa mesatarja e lëndëve të përfunduara pavarësisht se është më e ulët sesa numri i lëndëve të reja, proporcioni i lëndëve të zgjidhura në këtë gjykatë është më i lartë në krahasim me dy vitet prapake. Pavarësisht rritjes së numrit të lëndëve të përfunduara në krahasim me vitet tjera, duhet përmendur që Gjykata e Apelit ka pasur shtimin më të madh të numrit të gjyqtarëve të angazhuar nga viti paraprak dhe rritja si indikator mund të jetë e papërfillshme në krahasim me shtimin e potencialit për punë në këtë institucion. Janë gjykatat themelore të cilat nga mesatarja e lëndëve të përfunduara gjatë vitit 2018, kanë arritur të ulin dukshëm numrin e lëndëve të cilat i kanë trashëguar në vitin 2019, kjo pasi që numri i lëndëve të përfunduara është më i lartë sesa i lëndëve të reja të paraqitura në shkallën e parë të sistemit të drejtësisë. Nga tabela vërehet se dhe Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, e Gjykata e Apelit kanë trashëguar lëndë nga viti 2018 për vitin 2019. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme që të merret parasysh se në këtë tabelë nuk vlerësohet vështirësia e lëndëve e as mënyra e zgjidhjes së tyre, por konsiderohet vetëm aspekti sasior i punës së gjykatave për 1 vit kalendarik.

**Tabela I. Mesatarja e lëndëve të reja të pranuar kundrejt lëndëve të zgjidhura**

Viti	Gjykata Supreme	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	72	80
2017	89	88
2016	82	73
2015	74	78
2014	68	66
2013	56	113

Viti	Gjykata e Apelit	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	342	333
2017	367	330
2016	362	313
2015	320	286
2014	362	331
2013	334	344


Viti	Dhoma e Posaçme	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	114	106
2017	177	198
2016	146	190
2015	378	173
2014	950	263
2013	356	191

Viti	Gjykata Themelore	
	Mesatarja e lëndëve të reja	Mesatarja e lëndëve të zgjidhura
2018	361	582
2017	794	1153
2016	1621	1785
2015	1398	1376
2014	1422	1548
2013	1843	1474

## Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve

Efikasiteti i punës së gjykatave në zgjidhjen e lëndëve është kalkuluar duke vlerësuar raportin në mes të lëndëve të cilat ka pranuar secila gjykatë në fillim të vitit, në krahasim me numrin e lëndëve të përfunduara brenda atij viti. Kjo formë e matjes së efikasitetit të gjyqësorit nuk vlerëson vështirësinë e lëndëve të përfunduara si përmbajtje por vetëm numrin e lëndëve të përfundura si formë pra si sasi. Nga të dhënat për vitin 2018 duket se efikasitet në përfundimin e lëndëve kanë pasur më shumë gjykatat themelore, ku dhe kanë shënuar përqindjen më të lartë të efikasitetit në raport me vitet e kaluara. Ndërsa Dhoma e Posaçme ka pasur efikasitet më të ulët në krahasim me shkallët e tjera të gjyqësorit, si dhe në krahasim me efikasitetin e treguar në vitin 2017. Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit këtë vit kanë pasur një përqindje më të lartë në krahasim me përqindjen e efikasitet të treguar përgjatë vitit 2017. Indikatorin e efikasitetit të gjykatave në zgjidhjen e lëndëve të reja tregon se nga lëndët të cilat Gjykata Supreme me gjykatat themelore i kanë pranuar përgjatë vitit, nuk kanë lënë asnjë numër lëndësh për t'u trashëguar për vitin 2019, ndërsa kjo nuk vlen për Dhomën e Posaçme dhe Gjykatën e Apelit.

**Tabela II. Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve**



## Ngarkesa e gjyqtarëve

Përmes indikatorit të ngarkesës së gjyqtarëve përcaktohet ngarkesa mesatare e një gjyqtari brenda vitit duke mbledhur numrin total të lëndëve të cilat pritet t'i gjykoj në raport përpjestimi me numrin e gjyqtarëve të angazhuar. Ky indikator nuk merr parasysh vetëm numrin e lëndëve të reja të cilat arrijnë në gjykatë përgjatë vitit raportues, por shqyrton edhe ngarkesën me lëndë të trashëguara nga vitet paraprake, prandaj si i tillë në raport me indikatorin e efikasitetit e jep një pasqyrë më reale të kushteve të punës në të cilat gjyqtarët gjykojnë lëndë. Megjithatë, as ky indikator nuk vlerëson vështirësinë e lëndëve me të cilat ballafaqohen gjyqtarët gjatë procesit të gjykimit.

Ngarkesë më të ulët në vitin 2018 në krahasim me vitin paraprak, kanë shënuar gjyqtarët nga Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit dhe gjykatat themelore. Pra të gjitha shkallët e gjyqësorit në krahasim me vitet paraprake kanë pasur më pak ngarkesë për gjyqtar. Kjo mund të jetë si rezultat i rritjes së numrit të angazhuar të gjyqtarëve në çdonjërin nga institucionet e sistemit gjyqësor. Por pavarësisht nga ky indikator vërehet se gjykatat themelore vazhdojnë të kenë ngarkesë më të madhe me numrin e lëndëve të cilat pritet t'i përfundoj një gjyqtar, në krahasim me institucionet tjera. E mbi këtë bazë do të duhej që të rritej dhe numri i gjyqtarëve të angazhuar në të ardhmen në institucione. Ky indikator na paraqet nevojën e madhe për angazhim të një numri më të madh të gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe në Dhomën e Posaçme për të ulur ngarkesën e punës e për të rritur njëkohësisht efikasitetin.

**Tabela III. Ngarkesa e gjyqtarëve**

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore
2018	<b>86</b>	<b>1519</b>	<b>649</b>	<b>13303</b>
2017	<b>106</b>	<b>1837</b>	<b>680</b>	<b>2224</b>
2016	<b>88</b>	<b>1850</b>	<b>644</b>	<b>3187</b>
2015	<b>83</b>	<b>1876</b>	<b>539</b>	<b>2848</b>
2014	<b>75</b>	<b>2211</b>	<b>583</b>	<b>3080</b>
2013	<b>121</b>	<b>821</b>	<b>558</b>	<b>3133</b>

## Shkalla e mbipopullimit të gjykatave

Shkalla e mbipopullimit të gjykatave nga performanca brenda vitit që tregon secila shkallë e gjyqësorit, nxjerret koha për të cilën sipas përqindjes së efikasitetit do të mund të përfundonin të gjitha lëndët pa pranuar asnjë lëndë të re. Ky indikator gjithashtu supozon që efikasiteti i gjykatave do të jetë i njëtrajtshëm ndër vite. Kjo shkallë për vitin 2018 tregon se Dhomës së Posaçme dhe gjykatave themelore u është rritur koha për të cilën ato do të mund të përfundonin të gjitha lëndët në krahasim me të kaluarën. Dhomës së Posaçme do t'i duhet efikasiteti i punës maksimale dhe një kohë më e bollshme se 10 vite për të përfunduar vetëm lëndët të cilat i janë caktuar për t'u përfunduar. Ndërsa Gjykata e Apelit dhe Supremja kanë ulur kohën për të cilën do të mund të përfundojnë të gjitha lëndët, pa marrë lëndë të reja, në krahasim me vitet paraprake. Gjykatë së Apelit dhe Supreme do t'i duhej pak më shumë se një vit, ndërsa gjykatave themelore do t'u duhen më shumë se dy vite për të përfunduar të gjitha lëndët që i kanë në dispozicion.

**Tabela IV. Shkalla e mbipopullimit të gjykatave**

Gjykata Supreme					
2018					108
2017					120
2016					120
2015					107
2014					113
2013					107
Dhoma e Posaçme					
2018					1660
2017					926
2016					975
2015					1085
2014					841
2013					430
Gjykata e Apelit					
2018					195
2017					205
2016					206
2015					188
2014					176
2013					132
Gjykatat Themelore					
2018					228
2017					192
2016					179
2015					207
2014					199
2013					213

## Buxheti

Ndarja e buxhetit gjithmonë tregon për prioritetin që një sistem qeverisës mund t'i kushtoj një sektori të veçantë për ta zhvilluar dhe forcuar. Në këtë rast ndarja e buxhetit ndër vite për sistemin e drejtësisë, edhe tek buxheti i planifikuar për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, tregon se sistemi shtetëror nuk investon më shumë se 1% në sistemin e drejtësisë të Kosovës. Në vitin 2018 ka pasur një rritje të ndarjes së buxhetit të shtetit për KGJK-në por kjo rritje është e ulët në përpjestim me buxhetin shtetëror të Kosovës. Rritja e shpërndarjes së përqindjes për gjyqësorin nuk vjen si rezultat i prioritizimit të tij por si rezultat i rritjes progresive të buxhetit të shtetit të Kosovës. Përdersia vitetve të kaluara ishin ndarë për gjyqësorin 21 milionë EUR, në 2018-ën u ndanë 23 milionë EUR. Kjo rritje në shkallë të përpjestueshmërisë është e vogël në krahasim me vitet e tjera, por edhe si e tillë do të duhej të analizohet në mënyrë më të detajuar sesi kjo rritje do të mund të përdorej në të ardhmen për rritjen e performancës së sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Shpërndarja e buxhetit të paraparë për sistemin gjyqësor vë në pah se pjesa më e madhe e tij ndahet në sekotrin e pagave dhe mëditjeve. Kjo dukuri është prezente qysh nga 2013-a, porse përqindja tashmë e ndarë për paga shkon deri në 75% të buxhetit të ndarë për drejtësi, duke lënë 17% që shkon për mallra dhe shërbime. Ky indikator i ndarjes së buxhetit të përgjithshëm, tregon se ka mungesë të planifikimit dhe fokusimit në ngritjen e performancës dhe kapaciteteve të sistemit gjyqësor në Kosovë, nga ana e autoriteteve menaxhuese të sistemit të drejtësisë. Pra në tërësi nga 1% e buxhetit shtetëror që përcaktohet për sistemin e drejtësisë, më pak se 17% parashihet për aktivitete të rritjes së efikasiteti, performancës, e kapaciteteve humane në gjykata.

**Tabela V. Buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

	Buxheti i Këshillit Gjyqësor	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2018	23,495,024€	2,080,480,837€	1.13
2017	21,793,948€	2,001,020,484€	1.09
2016	20,465,770€	1,678,709,487€	1.22
2015	21,288,771€	1,682,486,849€	1.27
2014	20,833,483€	1,589,324,952€	1.31
2013	19,910,467€	1,591,118,599€	1.25

**Tabela VI. Shpërndarja e Buxhetit në Sistemin Gjyqësor të Kosovës në %**

### SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË SISTEMIN GJYQËSOR TË KOSOVËS NË %

	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione dhe Transfere	Shpenzime Kapitale
2018	75.47	17.32	1.92	1.49	3.81
2017	75.53	17.49	2.06	1.15	3.76
2016	73.35	17.65	2.20	0.12	5.58
2015	70.75	17.43	2.42	1.17	8.22
2014	64.85	20.96	2.91	1.20	10.08



# Rreth RoLPIK

RoLPIK ka për qëllim kryesor të promovoj përmirësimin epjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve në kërkimin e përgjegjësisë mbi performancën e sistemit të drejtësisë, përmes monitorimit, konsultimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

Për më shumë rreth platformës RoLPIK dhe Drejtësia Sot, vizitoni këtu:

[www.rolpik.org](http://www.rolpik.org)

[www.rolpik.org/justicetoday/](http://www.rolpik.org/justicetoday/)



---

*Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk i reflekton qëndrimet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe.*



